

NJOFTIM
Nr. 2248, datë 23.2.2024

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË QENVE TË POLICISË, TIRANË**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, i ndryshuar, kapitulli III, pika 16, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Aksi	16.6.2021	Tiranë	10,000	7.3.2024	10:00	DPSH

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.

2. Garancinë bankare apo mandatpagesën në origjinal, që vërteton ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Ministrisë së Financave.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave, pasi të keni tërhequr pranë DPSH-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave:
www.financa.gov.al.